

6100

6100

V E N D E M  
NEZ REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Ne Tirane, sot ne dt. 08.9.1994 u e gjyqtare e Gjykatës Brethit  
Tirane Florime Fajzi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga  
kerkuesi ARIF TURSIU për regjistrimin e personit juridik

K O N S T A T O V A

Kerkesa e paraqitur nga kerkuesi i sipërmë për regjistrimin  
e personit juridik te shoqerise "TURSIU" me objekt te veprimtaris  
se shpërndarje te ndertimeve civile, industriale, bujqesore, turistike  
e tj. dhe kompletimin e tyre me instalimet e nevojeshme, punime  
dheu, murature, beton, betonaraz, punime shembje, Punime restaurimi,  
vepra betonarazje te vegante, Pradhime te materjaleve te ndertimit  
dhe shitjen e tyre me pakice e shumice, Transport te materjaleve  
ndertimore me automobiliten, Ndertime te vepra ujetjellosa dhe  
kanalizime, Ujete e drejte dhe ne baze te ligjes duhet pranuar

PËR KETO ARSYE

Ne baze te nenit 5 te Ligjit 7312 dt. 10.8.1991 dhe Ligjit  
7638 dt. 19.11.1992

V E N D O R A

Regjistrimin e personit juridik te shoqerise te regjistrimit  
"TURSIU" P. S. me objekt te veprimtarise shpërndarje te  
ndertimeve civile, industriale, bujqesore, turistike e tj. dhe  
kompletimin e tyre me instalimet e nevojeshme, Punime dheu, murature,  
beton, betonaraz, punime shembje, Punime restaurimi, Vepra betonarazje  
te vegante, Pradhime te materjaleve te ndertimit dhe shitjen e  
tyre me pakice e shumice, Transport te materjaleve ndertimore me  
automobiliten, Ndertime te vepra ujetjellosa dhe kanalizime,

Ortak A Votim Arif Tursiu, Kapitali 10000 Leka, Regjistratja  
15 vjet, Selia ne Elbasan lagja e Re,

Kunder ketyr vendimi mund te behet ankim

Tirane 08.9.1994

G J Y Q T A R E

Florime Fajzi  
Fajzi

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E RRETHIT TIRANE**

Nr. \_\_\_\_\_

**V E N D I M**  
**“ I G J Y Q T A R I T T E V E T E M “**

Une gjyqtarja e vetme, *I. J. Terziu*, ne gjykatën e Rrethit Tirane, sot ne datën *09.09.1998* mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga z. **Iirjan TERZIU**, ne lidhje me shtimin e objektit te shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar “ **TERZIU “Sh.p.k.**

**K O N S T A T O V A :**

Se kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Iirjan TERZIU e depozituar prane Gjykates se Rrethit Tirane , ne baze te Vendimit Nr. 2 date 04.09.1998 te ortakut te vetem te shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar “ TERZIU “ Sh.p.k. per shtimin e objektit konforme ligjit 7667 date 28.01.1993, “ Per regjistrin tregetar “.

Kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne ligje dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARESYE**

Ne baze te ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 “ Per Regjistrin tregetar “, dhe te ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992.

**V E N D O S A :**

- Pranimin e kerkeses.
- Shtimin e objektit ne fushen e ndertimit dhe kryesisht

Kat. 1 - Punime dheu , sistemime , terracime terrenesh

Kat . 2 - a, c, g.

Kat . 3 - Ndertime civile dhe ekonomike

Kat. 4/a - ndertim rruge kat V, IV

b - ndertim rruge kat III , II, I

c - veshje me asfalto beton te rrugeve , ( ndertim mbishtrese ) si dhe

sistemim e asfaltim sheshe

Kat. 6 /a ndertim vepra arti te vogla deri 6 m

Kat 8/b ndertim ujesjellesa e kanalizime

c ndertim vepra kullimi ujitje toke e impiante vaditese

g - punime mbrojtjeje e sistemimi hidraulik

Kat . 9 - a, b

Kat . 10/a Rikonstruksione godina civile e ekonomike , veshje fasadash ,

etj .

V E N D I M

Ne qytetin e Tiranes, sot ne daten *04/03/* njemijenenqindenetdhjetete, une *Smila Cepo* gjyqetare ne gjykaten e rrethit, mora ne shqyrtim kerkesen e Arif Terziut, banor ne qytetin e Elbasanit dhe administrator i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " TERZIU " shpk dhe

K O N S T A T O V A

Se: Qytetari Arif Terziu, eshte themelues dhe ortak i vetem si dhe administrator i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " TERZIU SHPK " me qender ne lagjen e rre te qytetit Elbasan, e cila eshte regjistruar ne gjykaten e rrethit Tirane, me vendimin gjyqesor Nr 6100 dat 05 .09.1994.

ne qen se kerkesesi ne kerkesen e tij paraqet arsyetimet e tij se shoqerine larte fiksuar ja ka transferuar me kalim neperdjete kontrates se dhurimit, djali tij i quajtur ILIRJAN TERZIU, dhe nga fakti se jane respektuar te gjitha procedurat perkatese ligjore, si vendimi i assemblese, ortakut te vetem, kerkesa perkatese, deklarate noteriale te vet pranuesit te shoqerise, kontrates se dhurimit redaktuar dhe noteruar ne qytetin e Tiranes, dhe mbeshtetur ne dispozitat ligjore,

PER KETO ARSYE

Ne baze te nenit 47 i ligjes 7630 dat 19.11.1992, per shoqerit tregetare

V E N D O S A

Transferimin e shoqerise tregetare me pergjegjesi te kufizuar emertuar "TERZIU SHPK " me qender ne qytetin e Elbasanit, lagja e rre, qe deri tani ka qen prona e ortakut te vetem dhe themeluesit e administratorit te saj Z Arif Terziu, nga ky i fundit tek qytetari ILIRJAN TERZIU.

- Shoqeria tregetare ka kapitalin e saj themelues sipas statutit dhe aktit te themelimit,

- Kohezgjatja e aktivitetit te saj, eshte 15 vjet, sipas vendimit te meparshem,

- Administratori i shoqerise eshte Z. ILIRJAN TERZIU,

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ose protest ne gjykaten e Apelit Tirane, mbrenda afateve proceduriale.

Tirane me *04/03/* 1998

G J Y Q E T A R E

*Smila Cepo*  
*Cy*



b - restaurimi I momenteve te kultures

Kat. 11 /a - punime karpentierie druri .

Kat. 14 - a, b, c, d, punime sherbimi te zakoneshme te sistemit komunal dhe punime mirembajtjeje .

- Te ndahen regjistrimet nga njeri - tjetri me vije te kuqe.
- Kunder ketij Vendimi lejohet ankim ne shkalle te dyte.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
 GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR ELBASAN  
 NR. REGJ. THEMELTAR1527/67  
 NR. VENDIMIT 852

## V E N D I M

### NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Rrethit Gjyqsor Elbasan e perbere prej :

#### **GJYQTARIT SEANCES- ZIHNI SHAHU**

Asistuar prej sekretares Alketa Çerekja, sot ne date 13.05.2005 mori ne shqyrtim ne séance gjyqsore ceshtjen civile NR. 1527/67 akti qe i perket :

**P A D I T E S** – **Arif Terziu**, i biri i Abdylit dhe Fatimes, i datelindjes 1932, lindur e banues ne Elbasan, perfaqesuar me prokure te posaçme nga Av.Artan Kodheli.

**P A D I T U R** – **Ilirjan Terziu**, i biri i Arifit dhe Sanies, i datelindjes 1958, lindur dhe banues ne Elbasan, Lagja e Re, selia e firmes "Terziu".

**O B J E K T I** –Konstatimi i pavlefshmrise se kontrates se dhurimit Nr.574 rep. Nr.157 kol., date 03.03.1998.

**Baza ligjore** – Neni 32 i K.Pr.Civile, neni 92 i K.Civil dhe ligji 7638, date 19.11.1992 .

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor, te zhvilluar ne prani te paleve, gjykata pasi administroi provat e nevojshme e degjoi palet ne konkluzionet perfundimtare qe kerkuan :

Perfaqesuesin e paditesit, Av.Artan Kodheli qe kerkoj pranimin e padise,  
 Te paditurin dhe avokatin e tij, Adriatik Mukaj qe kerkuan rrezimin e padise,  
 e pasi shqyrtoi aktet e bisedoi ne teresi ceshtjen

## V E R E N

Me padine e tij drejtuar gjykates, paditesi ka kerkuar konstatimin e pavlefshmerise absolute te kontrates se dhurimit Nr.574 rep. dhe 157 kol, date 03.03.1998 te lidhur midis paleve ndergjyqese dhe zgjidhjen e pasojave qe kane ardhur nga kjo kontrate.

U provua ne gjykim se me vendimin gjyqsor te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, Nr.6100 date 05.09.1994 eshte krijuar sh.p.k. "Terziu" me ortak te vetem dhe administrator paditesin, Arif Terziu. Kjo shoqeri ka ushtruar aktivitetin e saj ne fushen e ndertimeve civile, industriale, turistike,etj si dhe ne prodhimin e materialeve te ndertimit ,etj. Deri ne date 04.03.1998 kjo shoqeri ka patur si ortak te vetem dhe administrator paditesin Arif Terziu, ndersa nga kjo date e ne vazhdim aksioner i vetem kesaj shoqerie eshte i padituri Ilirjan Terziu.Ky kalim pronesie, i te gjitha aksioneve te shoqerise "Terziu" nga paditesi tek i padituri, eshte bere nepermjet kontrates se dhurimit Nr.574 rep. dhe Nr.157 kol. date 03.03.1998. Pikerisht konstatimi i pavlefshmerise absolute te kesaj kontrate perben dhe objektin e ketij gjykimi, duke u pretenduar nga paditesi Arif Terziu se kjo kontrate eshte lidhur ne kundershtim me ligjin pasi ajo nuk eshte firmosur nga vete ai.

Nisur nga provat e marra ne séance gjyqesore sikunder jane :

- akti i ekspertimit grafik nenshkrimi Nr.5 date 22.04.2005 te realizuar nga Qendra e Mbrojtjes se Individit "The Experts", nepermjet ekspertit te saj Dritan Zoto, ku konkludohet ne menyre kategorike se shkrimi i emrit dhe firma ne dy kopjet origjinale te kontrates se dhurimit Nr.574/157, date 03.03.1998 midis dhuruesit Arif Terziu dhe pranuesit te dhurimit Ilirjan Terziu nuk eshte shkrimi origjinal i Arif Terziut, i krahesuar me modelet e marra ne gjykim. Ne interpretim te ketij konkluzioni te ekspertit, gjykata cmon se meqenese modelet e lira jane marre nga dokumente zyrtare qe konfirmojne autenticitetin e firmosjes nga Arif Terziu dhe modelet eksperimentale jane marre ne prani te gjykates, atehere konkludohet se firma e hedhur ne kontraten e dhurimit Nr.574/157, date 03.03.1998 nuk eshte e paditesit Arif Terziu.

- Prova e tjera shkresore te admnistruara ne séance gjyqesore, nder te tjera, a- **akt- marreveshja e dt. 15/01/1998** lidhur midis te paditurit Ilirjan Terziu dhe shtetasit Arben Terziu per caktimin e pjeseve reale te shoqerise " Terziu " ku ne asnje rast nuk parashikohej kalimi i aksioneve te shoqerise ne emer te ndonje personi e aq me pak ne emer te te paditurit Ilirjan Terziu,

b- **kontrata e shitjes** Nr.4621 Rep 741 Kol, dt. 01/4/1998, me te cilen paditesi ne cilesine e shitesit i ka shitur te paditurit ne cilesine e blesesit nje automjet, nderkohe qe e gjithë pasuria e shoqerise " Terziu " me kontraten e dhurimit objekt gjykimi, ka qene prone e te paditurit Ilirjan Terziu,

c- dhe provat e tjera shkresore te ndodhura ne dosjen gjyqesore si dhe shpjegimet e paleve ne proces, per gjykatën krijojnë bindjen se padia eshte e bazuar ne prova e ne ligj edhe si e tille duhet te pranohet.

Kjo detyron gjykatën qe te konstatoje pavlefshemrine absolute te kontrates se dhurimit Nr.574/157 date 03.03.1998 pasi ajo eshte bere ne kundërshtim me nje dispozite urdheruese te ligjit. Konkretisht si veprim juridik kontrata e dhurimit duhet te shpreh vullnetin e personit qe e realizon ate dhe ky vullnet materializohet nepermjet nenshkrimit te saj nga dhuruesi. Ne kete kontekst ne kete kontrate eshte shkelur neni 764 i K.Civil ku ligjvënësi ka urdheruar qe dhurimi te behet me akt publik. Kjo dispozite referon ligjin " Per noterine" i cili percakton menyren e berjes se aktit publik dhe cilat jane rastet kur ai konsiderohet i pavlefshem. Pikerisht neni 67/c i ligjit Nr.7829 date 01.06.1994 "Per Noterine" percakton ne menyre urdheruese se nje akt publik quhet i pavlefshem kur akti noterial eshte bere pa pranine e personit apo perfaqesuesit te tij me prokure.

Veprimi juridik i dhurimit nuk ka plotesuar kerkesat e nenit 79 e 81 te K.Civil, qe karakterizon ate si shfaqje te ligjshme te vullnetit te personit fizik ose juridik qe synon te krijoje ndryshoje ose te shuaje te drejta dhe detyrime juridike civile dhe qe perben kushtet per vlefshmerine e tij si veprim juridik. Ne rastin ne gjykim kontrata nuk eshte firmosur nga dhuruesi apo ndonje person tjetër i pajisur me prokure prej tij.

Ne konstatimin e kesaj pavlefshmeria gjykata ka parasysht dhe zgjidhjen e pasojave te ardhura nga ekzekutimi i saj, te cilat ne mbështetje te nenit 105 e 106 te K.Civil nenkuptojne se te gjitha veprimet e kryera nga i padituri pas realizimit te kontrates se dhurimit jane te pavlefshme, c'ka nenkupton se cdo gje duhet te kthehet ne gjendjen e meparshme, te gjitha veprimet e kryera nga i padituri prane te gjitha institucioneve ( Z.R.P.P. Elbasan, Drejtoria Rajonale e Sherbimeve te Transportit Rrugor, Rregjistri tregtar etj. ) per kalimin e pronesise



nr.574 rep e 157 kol date 03/03/1998 te lidhur ndermjet Arif Terziu dhe Ilirjan Terziu dhe zgjidhjen e pasojave qe kane ardhur nga kjo kontrate duke u pretenduar nga paditesi Arif Terziu se kjo kontrate eshte lidhur ne kundershtrim me ligjin pasi kjo nuk eshte firmosur nga vete ai.

Per te percaktuar nese nenshkrimi ne kontraten e dhurimit nr.574 rep e 157 kol date 03/03/1998 eshte i paditesit Arif Terziu gjykata me te drejte ka caktuar ekspert nga qendra e mbrojtjes se individit "The Expert" .

Ne baze te akt ekspertimit te perpiluar nga ekspert Dritan Zoto i kesaj qendre rezultoi se kontrata e dhurimit nr.574 rep dhe 157 kol date 03/03/1998 nuk eshte nenshkruar nga Arif Terziu me cilesine e dhuruesit .

Duke u bazuar ne aktekspertimin nr.5 date 22/04/2005 ne baze te cilit ka rezultuar se kontrata e dhurimit nr.574 rep e nr.157 kol date 03/03/1998 nuk eshte nenshkruar nga Arif Terziu me cilesine e dhuruesit gjykata me te drejte ka konstatuar absolutisht te pavlefshem kontraten e dhurimit te siperpermendur .

*Ndaj ketij vendimi ka bere ankim i padituri Arif Terziu i cili ne kerkes ankimore dhe ne seance gjyqsore ka pretenduar:*

1. Gjikata ne kryerjen e akt ekspertimit nuk ka zbatuar kerkesat e paragrafit te trete te nenit 269 te K.Pr.Civile qe te therriste dhe t'i merrte ne gjykate shkrimin dhe nenshkrimin paditesit Arif Terziu apo te dergonet si mostra krahasuese shkrime e nenshkrime te vitit 1998, kohe kur eshte nenshkruar kontrata .
2. Gjikata ka shkelur kerkesat e neneve 224/c, 226,227,228, te K.Pr.Civile pasi eksperti nuk eshte paraqitur per te bere betimin dhe per te marre detyrat nga palet para gjykates .

Pretendimet e ngritura nga i padituri Ilirjan Terziu nuk jane te bazuara ne ligj e ne prova e si te tilla nuk duhen pranuar pasi :

1. Nga Proçesverbali i seances gjyqsore date 22/11/2004 rezulton se paditesi Arif Terziu ka qene prezent ne kete seance gjyqsore dhe nenshkrimet eksperimentale te tij jane marre ne kete seance gjyqsore nga trupi gjykues ne perputhje me kerkesat e nenit 269/III te K.Pr.Civile

Gjithashtu gjykata bashkengjitur vendimit te saj per kryerjen e ekspertimit te nenshkrimin te paditesit Arif Terziu ne kontraten e dhurimit nr.574 rep e nr.157 kol date 03/03/1998 i ka vene ne dispozicion ekspertit dhe prova te tjera shtese sipas shteses nr.527/67 Akti date 14/04/2005.

2. Nga ana e gjykates eshte zbatuar kerkesa e nenit 226 te K.Pr.Civile , ne faqen 105 te dosjes gjyq ndodhet i administruar betimi i bere nga eksperti Dritan Zoto.

**PER KETO ARSYE**

Gjykata ne baze te nenit 466/a te K.Pr.Civile

**VENDOSI**

Lenien ne fuqi te vendimit nr.852 date 13/05/2005 te Gjykates se Shkalles se Pare Elbasan  
Durrës me 05/07/2005


**ANETAR**  
**Shkelqim MIRI**  
d.v

**ANETAR**  
**Naum PEJO**  
d.v

**KRYESUESE**  
**Valentina SADIRAJ**  
d.v




VERTETOHET NJESIA  
ME ORIGINALIN  
KANCELARE  
SUZANA MANDIA





**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E APELIT**  
**DURRES**  
Nr.427 Akti  
Nr. 354Vendimi



**VENDIM**

**“NE EMER TE REPUBLIKES”**

Gjykata e Apelit Durres, me trup gjykues te perbere nga:

**KRYESUES:** Valentina SADIRAJ  
**ANETAR:** Naum Pejo  
**ANETAR:** Shkelqim MIRI

Sot me date 05/07/2005 , mori ne shqyrtim ceshtjen civile ne qe i perket :

**PADITES** Arif Terziu perfaqsuar me prokure nga Artan Kodheli  
**I PADITUR:** Ilirian Terziu me avokat Adriatik Muka  
**OBJEKTI :** Konstatimin i pavlefshmerise se kontrates se dhurimit nr.574 rep, nr.157 kol date 03/03/1998

**BAZA LIGJORE:** Neni 32 i K.Pr.Civile, neni 92 i K.Civil dhe ligji 7638 date 19/11/1992

**Gjykata e shkalles se pare Elbasan me vendim nr.852 date 13/05/2005 ka vendosur:**

- Pranimin e kerkes padise .
- Konstatimin e pavlefshmerise absolute te kontrates se dhurimit nr.574 rep 157 Kol , date 03/03/1998 te lidhur midis paleve ndergjyqsa paditesit ( ne cilesine e dhuruesit) Arif Terziu dhe te



apo te aksioneve te shoqerise " Terziu " nga paditesi tek i padituri duhet te anulohen.

Pretendimet e pales se paditur, per perjashtimin e subjektit qe ka kryer aktin e ekspertimit ose riberjen e ketij akti, apo parashkrimin e te drejtes se padise, gjykata cmon se jane te pabazuara e nuk mund ti marre ne konsiderate sepse :

Ne veshtrim te nenit 80 e vijues te K.Pr.Civile, meqenese per ceshtjen kerkoheshin njohuri te posacme ne fushen e ekspertimit grafik, gjykata cmoi te caktoje ekspert nga Insituicioni i specializuar ne kete fushe te realizuar nga Qendra e Mbrojtjes se Individit " The Experts " dhe eksperti i saj Dritan Zoto, gjithashtu pala e paditur nuk parashtrroi asnje nga rastet e perjashtimi te ekspertit, konform nenit 72 te K.Pr.Civile.

Ne veshtrim te nenit 229 te K.Pr.Civile, duke cmuar qe ekspertimi ishte i qarte dhe pa te meta, dhe nuk kerkoheshin sqarime plotesuese per ceshtjen, gjykata nuk cmoi te nevojshme riberjen e ekspertimit;

Ne veshtrim te nenit 105 te K.Civil, meqense jemi para konstatimit te pavlefshmerise absolute te veprimit juridik, ai eshte nul qe nga casti kur eshte kryer, nuk parashkruhet dhe nuk sjell pasoja juridike per palet.

Hodhen drite e provuan sa siper shpegimet e paleve dhe provat shkresore te admnistruara ne séance gjyqesore.

### PER KETO ARSYE

Gjykata duke pare dhe nenin 126 dhe 306 te K.Pr.Civile


### V E N D O S I

- **Pranimin e kerkese - padise.**
  - **Konstatimin e pavlefshmerise absolute te kontrates se dhurimit Nr.574 Rep 157 Kol, date 03.03.1998** te lidhur midis paleve ndergjyqese paditesit ( ne cilesine e dhuruesit ) Arif Terziu dhe te paditurit( ne cilesine e pranuesit te dhurimit ) Ilirjan Terziu, si kontrate e lidhur ne kundershtim me ligjin.
  - **Kthimin e paleve ne gjendjen e meparshme** : fshirja e ndryshimeve te bera per shkak te regjistrimit te kesaj kontrate, ne Regjistrin Tregtar, ne Z.R.P.P. Elbasan e D.R.Sh.T.Rr. Elbasan.
  - **Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen te paditurit.**
  - Kunder vendimit mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Durres, brenda 15 diteve nga e nesermja e shpalljes se tij.
- U shpall ne Elbasan, sot me dt. 13/5/2005.

SEKRETARE  
/ ALKETA ÇEREKJA/



GJYQATAR  
/ ZIHNI SHAHU/



Shpenzimet gjyqsore 76500

Vendimi mori forme te prere dt

---

K/SEKRETARI  
/ SHABAN DEDJA/

KANCELARE  
/ MERITA DURO/



Gjykata e Rrethit Gjyqësor  
Elbasan

/ërtetohet se ky akt është i njëjtë  
ne origjinalin që ndodhet në  
Sekretarinë Gjyqësore Dt. 14/07/05

**V E N D I M**

**“ PER LESHIMIN E URDHERIT TE EKZEKUTIMIT “**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, e perbere prej :

**G J Y Q T A R E R O Z E T A M I N O**

Asistuar prej sekretares Elena Xhina, ne Elbasan, sot me date 14/7/2005, mori ne shqyrtim, ne séance gjyqësore publike, kerkesen per gjykim qe i perket :

**K E R K U E S :** Arif Terziu, i biri i Abdulit dhe Fatimes, i dtl. 1932, lindur e banues ne Elbasan, Lagja e re, Nr. 19.

**O B J E K T I :** Kerkohet leshimi i urdherit te ekzekutimit per vendimin civil Nr. 852, dt. 13/5/2005 te Gjykates se Rrethit Gjyqësor Elbasan.

**BAZA LIGJORE :** Neni 510 e 511 i K.Pr.Civile.

Gjykata pasi shqyrtoi aktet e bisedoi ceshtjen,

**V E R E N**

Me vendimin civil Nr. 852, dt. 13/5/2005, te Gjykates se Rrethit Gjyqësor Elbasan, i cili eshte lene ne fuqi nga Gjykata e Apelit Durres me vendimin Nr. 354, date 05/7/2005, nder te tjera eshte vendosur : “ ...Konstatimin e pavlefshmerise absolute te kontrates se dhurimit Nr. 574 Rep 157 Kol, date 03/3/1998 te lidhur midis paleve ndergjyqese paditesit ( ne cilesine e dhuruesit ) Arif Terziu dhe te paditurit ( ne cilesine e pranuesit te dhurimit ) Ilirjan Terziu, si kontrate e lidhur ne kundersiztim me ligjin.

Kthimin e paleve ne gjendjen e meparshme : fshirja e ndryshimeve te bera per shkak te regjistrimit te kesaj kontrate, ne Regjistrin Tregtar, ne Z.R.P.P. Elbasan e D.R.Sh.T.Rr. Elbasan “.

Meqenese ky vendim ka marre forme te prere, ne baze te nenit 510/a te K.Pr.Civile, ai perben titull ekzekutiv dhe si i tille konform nenit 511/a te K.Pr.Civile, gjykata cmon se duhet te leshohet urdheri i ekzekutimit.

**PER KETO ARSYE**

Gjykata duke pare dhe nenin 511 te K.Pr.Civile


**V E N D O S I**

- Leshimin e urdherit te ekzekutimit per vendimin civil Nr. 852, dt. 13/5/2005 te Gjykates se Rrethit Gjyqësor Elbasan, i cili ka marre forme te prere me vendimin Nr. 354, dt. 05/7/2005 te Gjykates se Apelit Durres.

- Vendimi eshte i formes se prere

U shpall ne Elbasan me 14/7/2005.

+



**G J Y Q T A R E**  
**R O Z E T A M I N O**

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE  
NR. 6100/3

**V E N D I M**  
**I G J Y Q T A R E S S E V E T M E**

Sot me date 20 10/2005, une, gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane **Ariana Caco**, pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga z. Arif Tereziu:

**K O N S T A T O V A :**

Me vendim te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nr. 6100 date 05.09.1994 eshte regjistruar si person juridik shoqeria **"Tereziu" sh.p.k. me** me seli ne Elbasan.

Me vendim Nr. 1 dt. 03.03.1998, te "Ortakut te Vetem" te shoqerise **"Tereziu"sh.p.k** eshte vendosur: Shitja e Kuotave 100 % nga z. Arif Tereziu tek z. Ilirjan Tereziu veprim I cili eshte kryer me ane te kontrates se dhurimit nr. 574/157 dt. 03.03.1998. Kjo kontrate dhurimi eshte konstatuar apsolutisht e pavlefshme e lidhur midis paleve si kontrate e lidhur ne kundersizim me ligjin. Kthimin e paleve ne gjendjen e meparshme, me vendimin nr. 852 dt. 13.05.2005 te Gjykates se Rrethit Elbasan vendim I cili eshte lene ne fuqi dhe ne Gjykatën e Apelit Durres me vendimin nr. 354 dt. 05.07.2005.

Perfundimisht ortak I vetem I shoqerise eshte z. Arif Tereziu me 100 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "Tereziu"sh.p.k.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

**P E R K E T O A R S Y E :**

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar"

**V E N D O S A :**

Pranimin e kerkeses.

Depozitim ne regjistrin tregetar te vendimit nr.852 dt. 13.05.2005 te Gjykates se Rrethit Elbasan dhe vendimi nr. 354 dt. 05.07.2005 te Gjykates se Apelit Durres.

Te behen shenimet perkatese ne regjistrin tregetar.

**G J Y Q T A R E**

**ARIANA CACO**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE**

6100/4

**V E N D I M**  
**I GJYQTARIT TE VETEM**

Sot me date 20 / 07 / 2005, une gjyqtare e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen per depozitimin ne regjistrin tregtar te vendimit nr.1, date 02.07.2004 te Ortakut te Vetem te Shoqerise "TERZIU" shpk

**K O N S T A T O V A:**

Me vendimin nr.6100, date 05.09.1994 te Gjykates se Rrethit Tirane, eshte vendosur regjistrimi si person juridik i shoqerise tregtare "TERZIU" shpk, me ortak te vetem themelues Z.Arif Terziu, me kapital themeltar 100 000 (njqindmije) leke, kontribut ky i ortakut te vetem themelues, me seli ne Lagjen "e Re" te qytetit te Elbasanit, me afat te veprimtarise 15 vjet, me administrator te shoqerise z.Arif Terziu dhe me objekt te saj, sipas aktit te themelimit dhe statutit te shoqerise.

Me vendimin nr.1, date 15.07.2005, ortakun e vetem themelues i shoqerise ka vendosur:

- 1- Largimin nga shoqeria te ortakut themelues Z.Arif Terziu, nepermjet transferimit (kontrates se shitjes) te kuotave te kapitalit prej 100% qe zoteron ne shoqerine "TERZIU" shpk, tek Z.Arben Terziu, i cili pas kesaj do te jete ortak i vetem i shoqerise, me pjesmarrje te kapitalit :  
Arben TERZIU 100% ose 100 000 (njqindmije) leke.
- 2- Emerimin si adminiatrator te shoqerise, ortakun e vetem Z.Arben Terziu.
- 3- Emri, selia, kohezgjatja, kapitali, vula e shoqerise, nuk kane ndryshim.
- 4- Ngarkohet administratori i ri, Z.Arben Terziu, te beje depozitimin e vendimit ne Regjistrin Tregtar, prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Ne keto kushte, kerkuesi kerkon depozitimin prane Regjistrin Tregtar te ketij vendimi. Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

**P E R K E T O A R S Y E:**

Ne baze te Ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite tregtare" si dhe Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar"

**V E N D O S A**

Pranimin e kerkeses.  
Depozitimin ne Regjistrin Tregtar te Vendimit nr.1, date 15.07.2005 te Ortakut te vetem te shoqerise "TERZIU" shpk.

- Largimin nga shoqeria te ortakut themelues Z.Arif Terziu, nepermjet transferimit (kontrates se shitjes) te kuotave te kapitalit prej 100% qe zoteron ne shoqerine "TERZIU" shpk, tek Z.Arben Terziu, i cili pas kesaj do te jete ortak i vetem i shoqerise, me pjesmarrje te kapitalit:

Arben Terziu 100% ose 100 000 leke.

- Emerimin si administratore shoqerise, ortakun e vetem Z.Arben Terziu.
- Emri, selia, kohezgjatja, kapitali, vula e shoqerise, nuk kane ndryshim.

Kunder vendimit lejohet ankim ne shkalle te dyte brenda afattit ligjor.

**GJYQTARE**

*Arif Terziu*





**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR TIRANE**

N 8.100 / 5

**V E N D I M**  
**I GJYQTARIT TE VETEM**

Sot me date 16 / 11 / 2006, une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane, pasi shqyrtova kerkesen per depozitim ne regjistrin tregtar te vendimit nr.2, date 06.11.2006 te ortakut te vetem te shoqerise "Terziu" shpk.

**K O N S T A T O V A:**

Shoqeria "TERZIU" sh.p.k, me qender ne Elbasan, eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr. 6100, date 05.09.1994 te Gjykates se Rrethit Tirane, me ortak te vetem themelues z. Arif Terziu, me kapital themeltar 100 000 leke, kontribut ky i ortakut te vetem themelues, me seli ne Lagjen "e Re", Elbasan, me afat veprimtarie 15 vjet, me objekt te kesaj veprimtarie sipas aktit te themelimit dhe statutit te shoqerise.

Me vendimin nr.6100/4, date 20.07.2005 te Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane, eshte vendosur :

1. Depozitimi i vendimit nr.1, date 15.07.2005 i ortakut te vetem.
2. Largimi nga shoqeria I ortakut themelues Z.Arif Terziu nepermjet transferimit te (kontrates se shitjes) 100% te kuotave tek Z. Arben Terziu, i cili pas kesaj do te jete Ortak i Vetem i saj, me pjesmarrije te kapitalit:  
Z. Arben Terziu - 100% ose 100 000 (njqindmije) leke.
3. Emerimi si administrator i shoqerise, i ortakut te vetem Z.Arben Terziu.
4. Emri, Selia, kohezgjatja, kapitali, vula e shoqerise, nuk kane ndryshim.

Me vendimin nr.2, date 06.11.2006 te ortakut te vetem, eshte vendosur:

- 1- Largimi nga shoqeria i ortakut te vetem Z.Arben Terziu, nepermjet transferimit te (kontrates se shitjes) 100% te kuotave tek Z. Feim Kadi, i cili pas kesaj do te jete Ortak i Vetem i saj, me pjesmarrije te kapitalit:  
Z. Feim Kadi - 100% ose 100 000 (njqindmije) leke.
2. Emerimin si administrator te shoqerise, ortakun e vetem Z.Feim Kadi.
3. Emri, Selia, kohezgjatja, kapitali, vula e shoqerise, nuk kane ndryshim.

Ne keto kushte, kerkuesi kerkon depozitim prane Regjistrin Tregtar te ketij Vendimi. Kerkesa e mesiperme eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARSYE:**

Ne baze te Ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite tregtare" si dhe Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar"

## V E N D O S A

- Pranimin e kerkeses.
  - Depozitimin ne Regjistrin Tregtar te Vendimit nr.2, date 06.11.2006 te ortakut te vetem te shoqerise "TERZIU" shpk.
  - Depozitimin e kontrates se shitjes nr. 1711 rep, nr 546 kol, date 06.11.2006
- Pas ketij depozitimi, kuotat e kapitalit themeltar zoterohen 100% nga ortaku i vetem Z.Feim Kadi.
- Emerimin si administrator te shoqerise Z.Feim Kadi.

Urdherohet berja e shenimeve perkatese ne regjistrin tregtar.

Kunder vendimit lejohet ankim ne shkalle te dyte brenda afatit ligjor.

GJYQTARE

*Arione Qumbardhi*  
*(Coco)*

REPUBLIKA E SHQIPERSE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
TIRANE

Nr 6100/ i Vendimit

=  
/ 6

VENDIM  
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane, ne gjykatën e rrethit gjyqesor ,sot ne dt 20. 06/2007,une gjyqtari Elvana Lemi ,pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi FEIM KADI administrator I shoqerise "TERZIU." SHPK

KONSTATOVA

-Me vendim te gjykates se rrethit gjyqesor Tirane Nr.6100 dt dt.05.09..1994 eshte rregjistruar si person juridik shoqeria "TERZIU" SHPK e cila aktualisht ka ortak te vetem dhe Administrator Z.FEIM KADIU

-Me vendim te Ortakut te Vetem te dt.16.06.2007 eshte vendosur :

-Pranimi si Ortake te shoqerise "TERZIU" shpk te Znj,Elisabeta TARTARI.

-Shitja 50% te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise "TERZIU"shpk nepermjet Kontrates se shitjes Znj.Elisabeta Vezir Tartari duke u bere ajo Ortake e Shoqerise "TERZIU" shpk me 50%(pesedhjetepaqind) te kapitalit themeltar.

-Administratori I Shoqerise "TERZIU" shpk mbetet Z,Feim KADI.

-Emri,selia e shoqerise,vula dhe kohezgjatja e saj nuk ndryshojne .

Kerkesa per depozitimim e Vendimit dt.16.06.2007 te Ortakut te Vetem dhe Administaror te Shoqerise "TERZIU"shpk Feim Kadi ne Gjykatën e rrethit Gjyqesor Tirane dhe rregjistrimin e saj ne rregjistrin tregtar gjendet e drejte dhe e bazuar ne ligj dhe si e till duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE :

Bazuar ne Ligjin Nr.7667 dt.28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar" dhe ne Ligjin Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"

s

V E N D O S A

b

-Pranimin e kerkeses.

-Depozitimim e Vendimit dt.16.06.2007 te Ortakut te Vetem shoqerise "TERZIU." Shpk FEIM KADI me te cilin eshte vendosur :

-Shitja e 50% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "TERZIU" shpk nepermejet Kontrates se shitjes Znj.Elisabeta TARTARI duke u bere ajo Ortake e Shoqerise "TERZIU"shpk me 50%(pesedhjeteprrerqind) te kapitalit themeltar

-Depozitim e Kontrates se shitjes se Kuotave me Nr.800 Rep dhe 279 Kol. dt,16.06.2007 te Noterit R.Leskaj nepermjet se ciles Znj.Elisabeta TARTARI 50% te kutave te kapitalit themeltar.dhe 50% ortakut FEIM KADI


-Administrator I Shoqerise "TERZIU" shpk mbetet Z.FEIM KADI.

-Selia,emir,vula,kohe zgjatja e shoqerise mbeten te pa ndryshuara.

-Te reflektohet ky ndryshim ne fleten perkatese te rregjistrimit tregtar te Gjykates se rrethit Gjyqesor Tirane dhe konkretisht ne kolonen..... germa .....

-Te ndahen rregjistrimet nga njeri tjetri.

G J Y Q T A R I



# S T A T U T I

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR SHPK

EMËRTUAR "SHOQËRIA TERZIU"

ME ORTAK TË VETËM

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

## Neni 1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) emërtohet "Shoqëri TERZIU Elbasan", ajo është më ortak të vetëm. Shoqëria është person Juridik shqiptar, e cila fiton të drejtën e aktivitetit me regjistrimin e saj në Gjykatën e rrethit Tiranë.

Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe dispozitat e parashikuara në statutin dhe aktivin e themelimit.

## Neni 2

Shoqëria me përgjegjësi të Kufizuar "TERZIU" ka objekt të veprimtarisë së saj si vijon :

a- ZBATIM TË NDERTIMEVE CIVILE, INDUSTRIALE, BUJQESORE, TURISTIAKE ETJ. DHE KOMPLETIMIN E TYRE ME INSTALIMET E NEVOJSHME.

b- PUNIME DHEU, MURATURE, BETONI, BETONARMEJE E PUNIME SHEMBJE.

c- PUNIME RESTAURIMI

ç- VEPRATË BETONARMEJE TË VECANTA

d- PRODUKTETË TË METARIALEVE TË NDERTIMIT DHE SHITJE TË TYRE ME PAKICE E SHUMICE.

f- TRANSPORTE TË MATERIALEVE NDERTIMORE ME AUTOMOBILIZEM

g- NDERTIME TË VEPRAVE UJESJELLESE DHE KANALIZIME.

## Neni 3

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "TERZIU" e ka selin e saj në Republikën e Shqipërisë në qytetin e Elbasanit, Lagjivë RË". Po ashtu ajo ka të drejtë të çelë degë dhe filiale edhe në qytete të tjera të territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

## Neni 4

Themeluesi i Shoqërisë, gëzon të drejtën për të marrë pjesë edhe në shoqëri të tjera e kjo pjesëmarrje nuk e pengon atë në zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë. Ajo nuk mer përgjegjësi për detyrimet ndaj aktiviteteve të shoqërive të tjera ashtu si dhe shoqëritë e tjera nuk marrin përsipër përgjegjësi për detyrimet që ka kjo shoqëri.



KREU I-II

## TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT TE VETEM

Neni 5

Ortaku i vetëm krijues i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "TERZIU" të drejtat e tjera si person i vetëm i ushtron nëpërmjet vendimeve që merr në mënyrë individuale.

-Ai merr pjesë në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë në të gjitha fushat e sajë, duke respektuar dispozitat e statutit dhe ligjet e shtetit.

-Mban evidenca të sakta për të gjithë veprimtarinë si në fushën ekonomike, administrative, ato juridike dhe kontraktuale.

-Drejton organin administrativ të shoqërisë në rast se emron të tillë, dhe jep udhëzimet e nevojshme për çuarjen e punëve përpara.

-Përgatit bilancin tremujor dhe vjetor të shoqërisë dhe kryen kontrollin e zbatimit të tij.

-Kryen depozitimin e kuotës së nevojshme të fondit themelor për shoqërinë duke treguar kujdes në respektimin rigoros të lëvizjes së shumave të tij.

-Grumbullon të dhëna për aktivitetin dhe evidenton ato në librat përkatës duke dërguar shifrat në organet shtetërore sipas përkatësisë ligjore.

-Respekton detyrimet e detyrimeve në organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore në përshatje të ligjës.

KREU I-III

## KUSHTET EKONOMIKE TE SHOQERISE

Neni 6

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në përshatje të bilancit ekonomik si dhe leverdisë që ka vetë themeluesi i saj.

Neni 7

Për të bërë të mundur zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë vihet një kapital bazë në vlerë leku në shumën 100.000 (njëqindmijë) shumë që përbën kapitalin bazë, i cili së bashku dhe me pasurinë e pa-  
1. luajtëshme dhe atë të luajtëshme, makineri, mjete dhe vegla pune për-  
bëhet fondi themelor i shoqërisë.

Neni 8

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore për 15 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit në gjykatën e rrethit

Tiranë deri në fund të vitit 2009. Pas këtij afati në përshtatje të leverdisë ekonomike, mund të bëhet zgjatja e afatit.

#### Neni 9

Shoqëria është pronare e të gjithë pasurisë së saj. Ajo ka të drejtë të përdorë, disponojë dhe tjetërsoj pasurinë e saj në përshtatje me vullnetin e themeluesit të saj.

#### Neni 10

Shoqëria mund të shtojë kapitalin e saj, nëpërmjet formave ligjore si dhe ka të drejtë të marrë kredi bankare për interesat e saja.

#### Neni 11

Shoqëria gëzon të gjitha të drejtat që garanton ligja shqiptare për sigurimin e pasurisë së saj si çdo ndërmarrje tjetër shtetërore dhe organizatë me karakter ekonomik.

#### Neni 12

Gjatë aktivitetit të saj, shoqëria krijon fondin rezervë dhe fondet e tjera të veçanta. Përbërja, shumat, burimet e sigurimit të tyre rregullat e përdorimit caktohen nga vetë themeluesi i shoqërisë.

#### Neni 13

Shoqëria disponon plotësisht të gjitha mjetet e veta financiare. Detyrimet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së saj, mbulohen nga fondet e rezervave ose fondet e tjera të caktuara për këtë qëllim.

#### Neni 14

Të ardhurat bruto të shoqërisë, pasi bëhen zbritjet e të gjitha shpenzimeve, si amortizimi, paga, blerje materiale, energji elektrike, përfitohet 100 % nga vetë themeluesi i saj.

#### Neni 15

Bilanci vjetor duhet të paraqitet brenda datës 31 mars të çdo viti pasardhës nga organi administrativ dhe pasi të jetë miratuar nga administratori.

#### Neni 16

E gjithë veprimtaria financiare e shoqërisë realizohet në bazë të planeve financiare si pjesë përbërëse e planit të veprimtarisë së shoqërisë. Në planet financiare parashikohen aktivi dhe pasivi i aktivitetit këto të shprehura në vlerë leku. Rezultatet financiare të shoqërisë taten në përputhje të bilancit vjetor.

Shkëmbimi i monedhës shqiptare me monedhë të huaj dhe e kundërta bëhet në përputhje të kursit të caktuar nga banka e shtetit Shqiptar.

ADMINISTRIMINeni 17

Organi i vetëm që drejton dhe administron të gjithë aktivitetin e shoqërisë është vetë administratori i saj Zoti ARIF TERZIU i cili është i vetmi person që krijon veprimtarinë e gëzon të drejtat individuale mbi të.

Neni 18

Vetë administratori i shoqërisë mer vendime dhe ato i zbaton vetë e nëpërmjet organeve administrative që mund të krijoj. Asnjë organ e person fizik tjetër veç tij nuk ka të drejtë të marrë vendime për aktivitetin e kësaj shoqërie.

Neni 19

Administratori i shoqërisë Z. ARIF TERZIU ka të drejtën të krijojë dokumentacionin e duhur të saj, të përcaktojë kuadrin në shoqëri, fuqinë punëtore, pagat dhe kohën e punësimit, duke respektuar kërkesat e nenit 19 të ligjit 7512 datë 10.08.1991.

Neni 20

Cakton rregulla dhe radhën e përdorimit të fondeve që ka në dispozicion shoqëria, mënyrën e ndarjes së tyre, likuidimin e detyrimeve të ndryshme që mund të ketë shoqëria gjatë aktivitetit të saj si dhe dokumentimin e sistemin e fitimeve që realizon shoqëria në një periudhë kohe të caktuar.

Neni 21

Vetë administratori ka të drejtë të caktojë komisionin e likuidimit të aktivitetit të shoqërisë.

Bën veprimtari konkrete për likuidimin e llogarive që u përkasin filialeve dhe degëve në rast se krijohen gjatë aktivitetit.

Të gjitha marrëdhëniet e punës ndërmjet administratorit dhe të punësuarve rregullohen në përshtatje të ligjit. Mosmarrëveshje zgjidhen me mirëkuptim, e kur kjo nuk arrihet seicila nga palët ka të drejtë për zgjidhje në rrugë gjyqësore në gjykatën kompetente.

KREU I-V

## MBYLLJA E SHQËRISË

Veprimtaria e shoqërisë "TERZIU" pushon se vepruari me prozim të organit administrativ kur ajo nga ana ekonomike rezulton me humbje ose kur vetë administratori vendos pushimin e aktivitetit për shkak të menduara prej tij.





Shoqëria mund të shpërndahet me riorganizim ose likuidim.

Neni 23

Në rast se vetë Administratori vendos të krvejë pushimin e aktivitetit të shoqërisë, ani në radhë të parë cakton komisionin e likuidimit i cili duhet të përgatisë të gjithë dokumentacionin dhe bilanci e likuidimit të shoqërisë.

Neni 24

Të gjitha pasuritë që janë vënë gjatë periudhës së aktivitetit të shoqërisë, mbeten pronë ekskluzive e vetë administratorit i cili mer vendime konkrete për sistemimin e tyre.

Po kështu vepron dhe në fondet dhe mjetet financiare kudo që janë depozituar, të gjitha i kalojnë vetë administratorit i cili detyrohet të bëjë të gjitha likuidimet e detyrimeve që mund të ketë shoqëria deri në atë periudhë kohe.

Neni 25

Në rast se pushon veprimtaria e një filiali ose degë të shoqërisë, kryhen të gjitha veprimet në mënyrë të niëllojtë sikur vepron edhe me pushimin e shoqërisë.

Mjetet financiare të depozituara në degë ose filial, i kalojnë në pronësi administratorit i cili bën sistemimin e tyre.

THEMBELUESI I SHOQËRISË

ADMINISTRATORI

ARIF TERZIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GOJKATA E RRETHIT TIRANË

NOTERIA  
Nr. 413 Rept.

Nr. 101 Volt akt.



Tiranë, më \_\_\_\_\_

VERTETIM

Në Tiranë, sot më dt. 1.09.1994 në gjykatën e rrethit Tiranë, në noteri parameje L. Kollusete, noter në Tiranë, u paraqit qytetari 1. Arif TERZIU, i biri Abdilit, datlindia 1932, lindur në Dibër, me banim në Elbasan, madhor i aftë për të kryer veprime juridike, i identifikuar nga unë nëpërmjet dokumentit që paraqiti, i cili kërkoi të bëhet vërtetimi noterial i statutit të veprimtarisë së shoqërisë krijuar prej tij, sepse vetë me vullnetin e tij e ka nënshkruar atë.

Unë noteri e vërtetoj sipas ligjit.



NOTERI

L. Kollusete

# K O N T R A T E

PER THEMELIMIN DHE AKTIVITETIN E SHOQERISE ME EMRIN "TERZIU"

E lidhur ndërmjet :

1. Z. ARIF TERZIU ( ortak i vetëm).

## Neni 1

Të krijohet një shoqëri të përbashkët me emrin "TERZIU" që do zhvillojë veprimtari ekonomik tregtare.

## Neni 2

Shoqëria ka statusin e personit juridik dhe selinë e saj e ka në ELBASAN: .Llogjia e RE, Nr.10.

## Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë, marrëdhëniet që lindin nga kjo kontratë, marrëdhëniet e saj me personat e tretë juridikë e fizikë privatë e shtetërorë vendas e të huaj rregullohen sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj bashkëlidhur dhe legjislacionit Shqiptar.

Statuti i shoqërisë i bashkëlidhet kësaj kontrate dhe është pjesë përbërëse e saj.

Shoqëria përgjigjet vetëm me pasurinë e saj.

## Neni 4

Veprimtaria e shoqërisë, emërtimi dhe silia e saj të përcaktuara në këtë kontratë nuk mund të ndryshojnë pa pëlqimin e ortakut të vetëm.

## Neni 5

Shoqëria ka për objekt ushtrimin e veprimtarisë ndërtimore dhe tregëtimit të materialeve të saj si dhe eksport import të mallrave industriale e transportin në përgjithësi, por më saktë ky aktivitet përcaktohet në Vendimin e regjistrimit si person juridik.

## Neni 6

Kapitali themelor i firmës është në shumën 100.000 lekë.

## Neni 7

Kjo kontratë lidhet për një afat pre 15 vjetësh duke filluar nga data e nënshkrimit të saj me të drejtën e zgjatjes së këtij afati.

## Neni 8

Fitimi i realizuar nga shoqëria, pas shlyerjes së detyrimeve li-



Kjo re dhe zbritjes së fondeve të tjera, shërben si fitim neto apo mjet për shtimin e vlerës së investimeve në kapitalin themelor të shoqërisë.

Neni 9

Organet e shoqërisë janë :

1. Presidenti i shoqërisë

Neni 10

Dispozita më të hollësishme rreth shoqërisë përcaktohen në statutin bashkëlidhur.

Neni 11


Kjo kontratë u hartua në tre kopje nga të cilat njëra dorëzohet në Gjykatën e rrethit, një tjetër në zyrën e tatimeve dhe një kopje mbahet në dokumentacionin e shoqërisë.

U nënshkrua në Tiranë më \_\_\_\_\_

ARIN TERZIU

*Arin Terziu*

*Arin Terziu*



Nr. 1545 Rep, Nr. 278 Kol.

Elbasan, me 15.07.2005

### KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Ne Elbasan, sot ne date 15.07.2005 (pesembedhete korrik dymijepese) perpara meje noteres Enkelejda Marinaj, me seli ne Lagjen "5 Maj" te qytetit te Elbasanit, perpara Gjykates se Rrethit Gjyqsor Elbasan, u paraqiten kontraktuesit si pale:

**Me cilesine e shitesit :** **ARIF TERZIU**, i biri i Abdylit dhe i Fatimese, dtl.03.02.1932, lindur ne Peshkopi e banues ne Elbasan, Lagja "e Re", mbajtes i pasaportes nr.0510360, leshuar me 05.11.1996.

**Me cilesine e bleresit:** **ARBEN TERZIU**, i biri i Arifit dhe i Sanijes, dtl.06.07.1963, lindur ne Elbasan me banim ne Austri, mbajtes i pasaportes austriake nr.C0010974 3, leshuar me 12.09.1997.

Qe te dy madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje, me pembajtje si me poshte vijon:

**Objekti i kontrates :** Shitblerje kuotash te shoqerise "TERZIU" shpk.

#### ***Kushtet e kontrates:***

Shoqeria "TERZIU" shpk, eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr.6100, date 05.09.1994 te Gjykates se Rrethit Tirane, me ortak te vetem themelues z. Arif Terziu, me kapital themeltar 100% kontribut i ortakut te vetem themelues, me seli ne Lagjen "e Re" Elbasan, me afat veprimtarie 15 vjet, me administrator te shoqerise z.Arif Terziu, dhe objekt veprimtarie, sipas akt-themelimit dhe statutit te shoqerise.

Me vendimin nr.1, date 15.07.2005 te ortakut te vetem, eshte vendosur largimi nga shoqeria si ortak i z.Arif Terziu, duke u kaluar ne favor te ortakut te ri z. Arben Terziu te gjitha kuotat prej 100% te kapitalit themeltar.

Nepermjet kesaj kontrate, realizohet shitja nga ana e shitesit Arif Terziu dhe blerja nga ana e bleresit Arben Terziu e teresise prej 100% te kuotave te kapitalit themeltar.

Shitesi Arif Terziu deklaroi se 100 % te kuotave te kapitalit themeltar, ia shet bleresit Arben Terziu.

Bleresi Arben Terziu, deklaroi se eshte dakort te bleje nga shitesi 100% te kuotave te kapitalit themeltar.

Palet deklarojne se jane shlyer totalisht me njera tjetren jashte kesaj zyre noterie.


Me lidhjen e kesaj kontrate, shitesi zhvishet nga pronesia mbi te gjitha kuotat e kapitalit themeltar, pronesi kjo qe i kalon bleresit, i cili behet ortak i vetem i shoqerise, duke zoteruar ne kete menyre 100% te kuotave te kapitalit te shoqerise.

Per sa me siper, redaktohet ky akt ne pese origjinale te njejte, ne perputhje te plote me vullnetin e porositesve te tij, lexohet prej tyre dhe nenshkruhet pa verejtje, nga vete ata ne pranine time noteres.

Une noterja, duke patur parasysh edhe kerkesat e nenit 705 e vijues te K.Civil, Ligjit 7638, date 19.11.1992, Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 si dhe Ligjit 7829, date 01.06.1994, "Per noterine", e vertetoj.

**SHITESI**

ARIF TERZIU




**BLERESI**

ARBEN TERZIU



**NOTERE**

Enkelejda Marinaj



### KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Ne Elbasan, sot ne date 15.07.2005 (pesembedhete korrik dymijepese) perpara meje noteres Enkelejda Marinaj, me seli ne Lagjen "5 Maj" te qytetit te Elbasanit, perpara Gjykates se Rrethit Gjyqsor Elbasan, u paraqiten kontraktuesit si pale:

**Me cilesine e shitesit :** **ARIF TERZIU**, i biri i Abdylit dhe i Fatimese, dtl.03.02.1932, lindur ne Peshkopi e banues ne Elbasan, Lagja "e Re", mbajtes i pasaportes nr.0510360, leshuar me 05.11.1996.

**Me cilesine e blesit:** **ARBEN TERZIU**, i biri i Arifit dhe i Sanijes, dtl.06.07.1963, lindur ne Elbasan me banim ne Austri, mbajtes i pasaportes austriake nr.C0010974 3, leshuar me 12.09.1997.

Qe te dy madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje, me pembajtje si me poshte vijon:

**Objekti i kontrates :** Shitblerje kuotash te shoqerise "TERZIU" shpk.

#### ***Kushtet e kontrates:***

Shoqeria "TERZIU" shpk, eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr.6100, date 05.09.1994 te Gjykates se Rrethit Tirane, me ortak te vetem themelues z. Arif Terziu, me kapital themeltar 100% kontribut i ortakut te vetem themelues, me seli ne Lagjen "e Re" Elbasan, me afat veprimtarie 15 vjet, me administrator te shoqerise z.Arif Terziu, dhe objekt veprimtarie, sipas akt-themelimit dhe statutit te shoqerise.

Me vendimin nr.1, date 15.07.2005 te ortakut te vetem, eshte vendosur largimi nga shoqeria si ortak i z.Arif Terziu, duke u kaluar ne favor te ortakut te ri z. Arben Terziu te gjitha kuotat prej 100% te kapitalit themeltar. Nepermjet kesaj kontrate, realizohet shitja nga ana e shitesit Arif Terziu dhe bletja nga ana e blesit Arben Terziu e teresise prej 100% te kuotave te kapitalit themeltar.

Shitesi Arif Terziu deklaroi se 100 % te kuotave te kapitalit themeltar, ia shet blesit Arben Terziu.

Bleresi Arben Terziu, deklaroi se eshte dakort te bleje nga shitesi 100% te kuotave te kapitalit themeltar.

Palet deklarojne se jane shlyer totalisht me njera tjetren jashte kesaj zyre noterie.


Me lidhjen e kesaj kontrate, shitesi zhvishet nga pronesia mbi te gjitha kuotat e kapitalit themeltar, pronesi kjo qe i kalon bleresit, i cili behet ortak i vetem i shoqerise, duke zoteruar ne kete menyre 100% te kuotave te kapitalit te shoqerise.

Per sa me siper, redaktohet ky akt ne pese origjinale te njejte, ne perputhje te plote me vullnetin e porositesve te tij, lexohet prej tyre dhe nenshkruhet pa verejtje, nga vete ata ne pranine time noteres.

Une noterja, duke patur parasysh edhe kerkesat e nenit 705 e vijues te K.Civil, Ligjit 7638, date 19.11.1992, Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 si dhe Ligjit 7829, date 01.06.1994, "Per noterine", e vertetoj.

**SHITESI**

ARIF TERZIU




**BLERESI**

ARBEN TERZIU



**NOTERE**

Erkelejda Marinaj



## V E N D I M

Nr. 1, date 15.07.2005

### I ortakut te vetem te Shoqerise "TERZIU" shpk

Shoqeria "TERZIU" shpk eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr. 6100, date 05.09.1994 te Gjykates se Rrethit Tirane, me ortak te vetem themelues z. Arif Terziu, me kapital themeltar 100 000 leke, kontribut ky i ortakut te vetem themelues, me seli ne Lagjen "e Re", Elbasan, me afat veprimtarie 15 vjet, me objekt te kesaj veprimtarie sipas aktit te themelimit dhe statutit te shoqerise.

Me vendimin nr.1, date 15.07.2005, kerkohet largimi i ortakut themelues Z.Arif Terziu, nepermjet transferimit (shitjes) teresisht te kapitalit ose 100% te kuotave, Z. Arben Terziu, si dhe emerimi i ketij te fundit si administrator i shoqerise "TERZIU" shpk.

### PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit 7638, date 19.12.1992 si dhe dispozitave te statutit

## V E N D O S I


1. Largimin nga shoqeria te ortakut themelues Z.Arif Terziu nepermjet transferimit te (kontrates se shitjes) 100% te kuotave, Z. Arben Terziu, i cili pas kesaj do te jete Ortak i Vetem i saj, me pjesmarrje te kapitalit:

Z. Arben Terziu - 100% ose 100 000 (njeqindmije) leke.

2. Emerimin si administrator te shoqerise te ortakut te vetem Z.Arben Terziu.
3. Emri, Selia, kohezgjatja, kapitali, vula e shoqerise, nuk kane ndryshim.
4. Ngarkohet administratori i ri i shoqerise, Z.Arben Terziu, te beje depozitimimin e vendimit te ne Regjistrin Tregtar, prane Gjykates se Rrethit Tirane.

### ORTAKU I VETEM

ARIF TERZIU





REPubLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE ELBASAN  
NOTERE Enkelejda Marinaj

Nr. 1545 Rep, Nr. 278 Kol.

Elbasan, më 15.07.2005

### VERTETIM


Ne Elbasan, sot ne date 15.07.2005 (pesëmbëdhjete korrik dymijepese), perpara meje noteres *Enkelejda Marinaj*, me seli ne Lagjen "5 Maj" te qytetit te Elbasanit, prane Gjykates se Rrethit Gjyqsor Elbasan, u paraqit personalisht:

**ARIF TERZIU**, i biri i Abdylit dhe i Fatimese, dtl.03.02.1932, lindur ne Peshkopi e banues ne Elbasan, Lagja "e Re", nr.9, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes nr.0510360, leshuar me 05.11.1996, i cili aktin e mesiperme nenshkroi ne pranine time noteres.

Une noterja konfirmoj nenshkrimin e tij

**NOTERE**

*Enkelejda Marinaj*



## **V E N D I M**

**Nr. 1, date 15.07.2005**

### **I ortakut te vetem te Shoqerise "TERZIU" shpk**

Shoqeria "TERZIU" shpk eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr. 6100, date 05.09.1994 te Gjykates se Rrethit Tirane, me ortak te vetem themelues z. Arif Terziu, me kapital themeltar 100 000 leke, kontribut ky i ortakut te vetem themelues, me seli ne Lagjen "e Re", Elbasan, me afat veprimtarie 15 vjet, me objekt te kesaj veprimtarie sipas aktit te themelimit dhe statutit te shoqerise.

Me vendimin nr.1, date 15.07.2005, kerkohet largimi i ortakut themelues Z.Arif Terziu, nepermjet transferimit (shitjes) teresisht te kapitalit ose 100% te kuotave, Z. Arben Terziu, si dhe emerimi i ketij te fundit si administrator i shoqerise "TERZIU" shpk.

## **PER KETO ARSYE**

Ne baze te Ligjit 7638, date 19.12.1992 si dhe dispozitave te statutit

## **V E N D O S I**


1. Largimin nga shoqeria te ortakut themelues Z.Arif Terziu nepermjet transferimit te (kontrates se shitjes) 100% te kuotave, Z. Arben Terziu, i cili pas kesaj do te jete Ortak i Vetem i saj, me pjesmarrje te kapitalit:



Z. Arben Terziu - 100% ose 100 000 (njeqindmije) leke.

2. Emerimin si administrator te shoqerise te ortakut te vetem Z.Arben Terziu.
3. Emri, Selia, kohezgjatja, kapitali, vula e shoqerise, nuk kane ndryshim.
4. Ngarkohet administratori i ri i shoqerise, Z.Arben Terziu, te beje depozitimimin e vendimit te ne Regjistrin Tregtar, prane Gjykates se Rrethit Tirane.

## **ORTAKU I VETEM**

ARIF TERZIU





**VERTETIM**

